



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr

Dt: 03.03.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe Përfundimit nr.06 12830-18/2 të miratuar me dt: 12.02.2015 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e OJQ Shoqata e të verbërve të Gjakovës për ndihmë financiare për vazhdimin e aktiviteteve dhe veprimtarisë së kësaj shoqate , me dt: 03.03.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Shoqatës së të verbërve të Gjakovës, e evidentuar me nr. 01-400-9282 e dt: 02.02.2015, për mbështetje financiare të kësaj shoqate për mbarëvajtjen e veprimtarisë gjatë vitit 2015, duke e ndihmuar me subvencione të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në vlerë prej 1.500€ .

II. Autorizohet Drejtorja për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1.500€, nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e Shoqatës së të verbërve në Gjakovë, nr. 1402000001755635 Banka Ekonomike.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

IV. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Z.Shaip Kastrati, kryetar i Shoqatës së të verbërve në Gjakovë, rr. “Anton Qetta “ nr. 18/1 .
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila